

VENDIM

Nr.173, date 7.3.2003

PER EMERIMIN, LIRIMIN OSE SHKARKIMIN NGA DETYRA TE DREJTUESVE TE INSTITUCIONEVE, NE VARESI TE KESHILLIT TE MINISTRAVE, KRYEMINISTRIT OSE TE MINISTRIT

Ne mbështetje te nenit 100 te Kushtetutës, me propozimin e Ministrit te Shtetit pranë Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Drejtuesit e institucioneve, ne varësi te Këshillit te Ministrave, Kryeministrit ose te ministrit emërohen, lirohen ose shkarkohen nga detyra, përkatësisht nga Kryeministri ose ministri përkatës, ne rast se dispozita te tjera, te veçanta, ligjore dhe nënligjore, nuk parashikojnë ndryshe.
2. Emërimi i drejtuesve te institucioneve te treguara ne piken 1 behet sipas kërkesave dhe procedurave te mëposhtme:
 - Kryeministri ose ministri përkatës urdhërojnë, te paktën 15 dite përpara datës se emërimit, shpalljen ne media te vendit te lire.
 - Kandidatet e paraqitur, krahas kërkesave te përgjithshme për t'u punësuar ne shërbimin civil, sipas nenit 12 te ligjit nr. 2549, date 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", duhet te plotësojnë edhe kërkesat e veçanta, te cilat jepen ne shpalljen ne media te vendit te lire.
 - Kryeministri ose ministri përkatës përzgjedh dhe emëron njëren nga kandidaturat e paraqitura qe plotëson kërkesat e mësipërme.
3. Lirimi ose shkarkimi i drejtuesve te institucioneve te treguara ne piken 1, duhet te jete i motivuar, pasi te jene dëgjuar edhe pretendimet e personit.
4. Kur ne dispozita te tjera, te veçanta, ligjore dhe nënligjore, është përcaktuar organi i emërtesës për drejtuesit e institucioneve, ne varësi te Këshillit te Ministrave, Kryeministrit ose te ministrit, por nuk përcaktohen kërkesat dhe procedurat për emërimin, lirimin ose shkarkimin e tyre, ne këto raste zbatohen pikat 2 dhe 3 te këtij vendimi.
5. Kur ne dispozita te veçanta, ligjore dhe nënligjore, përcaktohet se drejtuesi i institucionit, ne varësi te Këshillit te Ministrave, Kryeministrit ose te ministrit, emërohet, lirohet ose shkarkohet nga Këshilli i Ministrave, por qe nuk janë parashikuar kërkesat dhe procedurat për emërimin, lirimin ose shkarkimin e tyre, zbatohen kërkesat dhe procedurat e mëposhtme:
 - Procedura e emërimit, lirimit ose shkarkimit fillon nga Kryeministri ose ministri përkatës, sipas varësisë se institucionit.
 - Kryeministri ose ministri përkatës urdhërojnë, te paktën 15 dite përpara datës se emërimit, shpalljen ne media te vendit te lire.
 - Kandidatet e paraqitur duhet te përmbushin, krahas kërkesave te përgjithshme për t'u punësuar ne shërbimin civil, sipas nenit 12 te ligjit nr.8549, date 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", edhe kërkesat e veçanta, te cilat jepen ne shpalljen ne media te vendit te lire.
 - Kryeministri ose ministri përkatës i propozojnë Këshillit te Ministrave jo me shume se tri nga kandidaturat e paraqitura, qe plotësojnë kërkesat e mësipërme.
 - Këshilli i Ministrave përzgjedh dhe vendos, me shumicën e anëtarëve, emërimin e njërit prej kandidatëve.
 - Propozimi i lirimit ose shkarkimit duhet te jete i motivuar, pasi te jene dëgjuar pretendimet e personit.

- Këshilli i Ministrave, ne mbledhjen e vet te pare, merr vendimin për propozimin e liritimit ose te shkarkimit.

6. Vendimi nr.469, date 14.8.1995, i Këshillit te Ministrave "Për kompetencat për emërimin dhe largimin nga detyra te drejtoreve te drejtorive ne ministri dhe institucione te tjera qendrore dhe ndryshimet ne strukturat e tyre", shfuqizohet.

Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano